



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:002917

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05459242

C.nr.706/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.V., Q.S., S.S., S.H. dhe F.Sh.Ç., të gjithë nga Skenderaj të cilët i përfaqëson me autorizim Q.R. avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria për Arsim, të cilën e përfaqëson E.B., për kompensimin ne pagë në bazë të rritjes së inflacionit dhe kompensim ushqimi, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqjese në procedurën e ndërmjetësimit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 15.03.2024, jep këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE me nr. të referencës së Ndërmjetësimit ND.331/2024 e datës 23.02.2024 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim të ndërmjetësuesit N.O., në mes të paditësve N.V., Q.S., S.S., S.H. dhe F.Sh.Ç., të cilët i përfaqësoi me autorizim Q.R. avokat në Skenderaj dhe të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria për Arsim të cilën e përfaqësoi E.B., me objekt kontesti kompensimin ne pagë në bazë të rritjes së inflacionit dhe kompensim ushqimi.

II. Pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi është Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.331/2024, e datës 23.02.2024, e cila e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

A r s y e t i m

Paditësit në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të saj ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin ne pagë në bazë të rritjes së inflacionit dhe kompensimin e ushqimit, në të cilën kanë theksuar se janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër detyrimit të të paditurës nuk e kanë realizuar kompensimin ne pagë në bazë të rritjes së inflacionit kompensimin e ushqimit. Tutje kanë pohuar se edhe pse i janë drejtuar me kërkesë të paditurës për përmbushjen e obligimit, nga e paditura nuk kanë marrë përgjigje, andaj kanë kërkuar mbrojtje gjyqësore nga gjykata duke kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të kompensimit ne pagë në bazë të rritjes së inflacionit dhe kompensimin e ushqimit, të ia paguaj detyrimin dhe i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura me datë 04.01.2024 i ka dorëzuar gjykatës një parashtrësë përmes së cilës ka kërkuar nga gjykata që këtë çështje juridike kontestimore ta referojë në procedurë të ndërmjetësimit, duke i propozuar gjykatës që për këtë të njoftohen paditësit.

Me datë 27.02.2024 gjykata ka pranuar marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND.331/2024 të dt.23.02.2024.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes se ndërmjetësimit me nr. të referencës ND.331/2024, të datës 23.02.2024 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim të ndërmjetësuesit N.O., në mes të paditësve dhe të paditurës, me objekt të kontestit kompensimin ne pagë në bazë të rritjes së inflacionit dhe kompensimin e ushqimit (për më tepër sikurse në marrëveshjen e datës 23.02.2024, pjesë e shkresave të lëndës), vlerëson se kjo marrëveshje i plotëson kushtet ligjore, pasi që kjo gjykatë ka konstatuar se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me Ligjin dhe për këtë arsye bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 411 dhe 412 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 14, 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësimin me nr. 06/L-009, erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore ND.nr.331/2024 e datës 23.02.2024 duhet të miratohet dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

Nga sa u tha më lartë, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.706/2023 me datë 15.03.2024

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.